



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 03/L-099**

**PËR LETËRNJOFTIMIN**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në bazë të nenit 65, pika (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Më qëllim të vendosjes së rregullave ligjore për letërnjoftimin e Republikës së Kosovës;

Miraton këtë

**LIGJ PËR LETËRNJOFTIMIN**

**K R E U I**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj përcakton rregullat ligjore të dhënies së letërnjoftimit, kompetencën si dhe procedurën e lëshuarjes së letërnjoftimit për shtetasit e Republikës së Kosovës.

## **Neni 2**

### **Përkufizimet**

Nocionet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

**“Letërnjoftim”** nënkupton dokumentin zyrtar me të cilin shtetasi i Republikës së Kosovës vërteton identitetin e tij personal: shtetësinë, gjininë, datën e lindjes, vendlindjen si dhe adresën ku banon (vendqëndrimin).

**“Letërnjoftimi për të huaj”** është dokument zyrtar me të cilin pajiset qytetari i cili në kohën e dhënies së këtij letërnjoftimi e ka të lejuar qëndrimin e përkohshëm apo qëndrimin e përhershëm në Republikën e Kosovës.

**“Qytetar”** është shtetasi i Republikës së Kosovës apo i huaji, i cili sipas dispozitave të këtij ligji duhet të pajiset me letërnjoftim.

**“Ministria”** nënkupton Ministria e Punëve të Brendshme.

**“Të dhënat biometrike”** janë të dhëna unike që paraqesin karakteristikat unike të individit dhe shërbejnë për të përcaktuar identitetin përmes pamjes së fytyrës (portretit), shenjave të gishtërinjve, ngjyrës së syve dhe grupi i gjakut.

**“Qëndrimi i përhershëm”** nënkuptojmë vendin në të cilin shtetasi vendoset me qëllim që të jetojë përgjithmonë.

**“Ditët”** nënkupton ditët e punës.

## **Neni 3**

Letërnjoftimi mund të shërbejë si dokument identifikues (udhëtimi) për kalimin e kufirit shtetëror, në qoftë se kjo është e rregulluar me marrëveshje ndërmjet shteteve.

## **Neni 4**

4.1 Çdo shtetas i Republikës së Kosovës më i vjetër se gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç, është i detyruar të pajiset me letërnjoftim.

4.2 Te drejtën për t’u pajisur me letërnjoftim për të Huaj, e ka qytetari i cili në kohën e dhënies së këtij letërnjoftimi, e ka të rregulluar qëndrimin e përkohshëm apo qëndrimin e përhershëm në Republikën e Kosovës.

4.3 Shtetasi nuk mund të posedojë me shumë se një letërnjoftim të lëshuar në Republikën e Kosovës.

## **Neni 5**

Shtetasi është i detyruar të ketë letërnjoftimin me vete, dhe me kërkesën e personit zyrtar të autorizuar me ligj, është i detyruar që t'ia japë letërnjoftimin për identifikim.

## **Neni 6**

6.1 Shtetasi nuk ka të drejtë të japë letërnjoftimin e vet personit tjetër për përdorim apo ta përdorë letërnjoftimin e huaj si të vetin.

6.2 Letërnjoftimi i huaj nuk lejohet të keqpërdoret me qëllim të sigurimit të ndonjë përfitimi apo të drejte, për vete ose një personi tjetër fizik ose juridik.

# **K R E U II**

## **KOMPETENCAT DHE MËNYRA E DHËNIES SË LETËRNJOFTIMIT**

## **Neni 7**

Organ kompetent për dhënien e letërnjoftimit është Ministria e Punëve të Brendshme (në vazhdim të tekstit: Ministria).

## **Neni 8**

8.1 Formën e letërnjoftimit e përcakton Ministria.

8.2 Letërnjoftimi përmban:

- a) simbolin e shtetit të Kosovës;
- b) emrin e dokumentit;
- c) numrin serik të letërnjoftimit;
- d) vendin e regjistrimit;
- e) emrin dhe mbiemrin;
- f) datën dhe vendin e lindjes;
- g) gjininë;
- h) shtetësinë;
- i) numrin personal;

j) afatin e kohëzgjatjes; dhe

k) vendin dhe organin që e lëshon letërnjoftimin;

8.3 Letërnjoftimi përmban fotografinë dhe të dhënat biometrike të bartësit të dokumentit.

8.4 Format e formularëve për tu pajisur me letërnjoftim, letërnjoftim të humbur, të dëmtuar, përcaktohen me akt nënligjor dhe në pajtueshmëri me dispozitat e këtij ligji.

8.5 Procesimi, personalizimi dhe prodhimi i letërnjoftimit bëhet nga Ministria.

8.6 Shpërndarjen e letërnjoftimit e bënë organi i caktuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

8.7 Formularët për tu pajisur me letërnjoftim prodhohen nga personi juridik, i autorizuar nga Ministria.

### **Neni 9**

9.1 Formularët dhe letërnjoftimi shtypen në gjuhët zyrtare dhe gjuhët zyrtare të komunave të Republikës së Kosovës.

9.2 Formularët dhe letërnjoftimi shtypen në alfabetin latin

## **K R E U III**

### **VLEFSHMËRIA E LETËRNJOFTIMIT**

#### **Neni 10**

10.1 Letërnjoftimi jepet në vlefshmëri prej dhjetë (10) viteve.

10.2 Për personat e moshës gjashtëmbëdhjetë (16) deri në njëzetegjashtë (26) vjet letërnjoftimi u jepet me vlefshmëri prej pesë (5) viteve.

10.3 Për personat më të vjetër se gjashtëdhjetë (60) vjet letërnjoftimi u jepet në vlefshmëri të përhershme.

#### **Neni 11**

11.1 Bartësi i letërnjoftimit i cili brenda pesë viteve humb, dëmton apo tjetërson dy apo më shumë letërnjoftime, i jepet letërnjoftimi në kohëzgjatje prej një viti.

11.2 Dispozita nga paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet, nëse shtetasi, të cilit i është tjetërsuar letërnjoftimi, argumenton që tjetërsimin e ka lajmëruar si vepër penale.

## **Neni 12**

12.1 Personi të cilit i është ndaluar largimi jashtë vendit, nuk mund ta përdorë letërnjoftimin për këtë qellim gjatë afatit të ndalimit.

12.2 Lidhur me ndalesën vendos vetëm gjykata e cila njofton Ministrinë.

12.3 Ankesa kundër vendimit nga paragrafi 2 i këtij neni nuk e ndalon ekzekutimin e tij.

12.4 Pas pushimit të arsyeve për ndalesën e përdorimit të letërnjoftimit për kalimin e kufirit shtetëror gjykata nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të lajmërojë menjëherë Ministrinë.

## **Neni 13**

13.1 Shtetasi duhet që brenda tridhjetë (30) ditëve të bëjë kërkesën dhe të dorëzojë letërnjoftimin në organin kompetent nëse:

- a) ndërron emrin dhe mbiemrin;
- b) ndërron vendbanimin e përhershëm;
- c) fotografia nuk tregon më pamjen e tij të vërtetë.

13.2 Shtetasi nga paragrafi 1 i këtij neni, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për lëshimin e letërnjoftimit të ri, sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 16 të këtij ligji.

## **Neni 14**

14.1 Pavarësisht nga kushtet e parapara në nenin 10 të këtij ligji, vlefshmëria e letërnjoftimit skadon:

- a) me vdekjen e personit;
- b) me humbjen e shtetësisë së Kosovës;
- c) nëse shtetasi e çlajmëron vendbanimin për shkak të shpërnguljes nga Republika e Kosovës;
- d) me kalimin e afatit të vlefshmërisë.

14.2 Poseduesi i letërnjoftimit nga pika b) dhe c), paragrafi 1 i këtij neni, duhet që Letërnjoftimin t'ia dorëzojë organit kompetent brenda tetë ditëve pas paraqitjes së arsyeve nga pika b dhe c e paragrafit 1 të këtij neni.

## **K R E U I V**

### **LËSHIMI I LETËRNJOFTIMIT**

#### **Neni 15**

15.1 Shtetasi e paraqet personalisht kërkesën për tu pajisur me letërnjoftim në organin kompetent.

15.2 Për shtetasit më të rinj se tetëmbëdhjetë (18) vjet si dhe shtetasit që nuk kanë zotësi veprimi kërkesën e paraqet përfaqësuesi ligjor.

15.3 Organi kompetent i lëshon paraqitësit të kërkesës dëshmi mbi pranimin e kërkesës.

#### **Neni 16**

16.1 Kërkesa për tu pajisur me letërnjoftim bëhet me formularë të paraparë.

16.2. Formulari nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të përmbajë të dhënat paraprake:

- a) emrin dhe mbiemrin;
- b) datën e lindjes, vendin e lindjes, numrin personal dhe gjininë;
- c) vendbanimin;
- d) vendqëndrimin;
- e) shtetësinë;
- f) emrat e prindërve, datat e lindjes dhe numrat personal;
- g) datën dhe vendin e paraqitjes së kërkesës;
- h) emrin dhe mbiemrin si dhe vendbanimi i përfaqësuesit ligjor.

16.3 Kërkesës për tu pajisur me letërnjoftim, organi kompetent duhet t'i bashkëngjes në format elektronike shënimet biometrike si fotografia, shenjat e gishtërinjve, nënshkrimi, në harmoni me standardet ndërkombëtare.

16.4 Në kërkesën për tu pajisur me letërnjoftim, të dhënat duhet të jenë të sakta.

16.5 Organi kompetent është i detyruar të lëshojë letërnjoftimin, më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës.

16.6 Letërnjoftimi mund t'i dorëzohet shtetasit drejtpërdrejt nga organi kompetent.

16.7. Nëse shtetasi nuk e tërheq letërnjoftimin brenda tridhjetë (30) ditëve, letërnjoftimi i kthehet organit kompetent.

16.8. Përjashtimisht nga paragrafi 7 i këtij neni në raste të arsyeshme afati për tërheqjen e letërnjoftimit mund të zgjatet për një kohë arsyeshme, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

### **Neni 17**

17.1 Dëmtimin, humbjen apo vjedhjen e letërnjoftimit, shtetasi duhet ta lajmërojë të organi kompetent brenda tetë ditëve, duke bërë përshkrimin e rrethanave të dëmtimit, humbjes apo vjedhjes së letërnjoftimit.

17.2 Dëmtimin, humbjen apo vjedhjen e letërnjoftimit jashtë vendit, shtetasi duhet që brenda tetë ditëve pas hyrjes në Republikën e Kosovës, të lajmërojë organin kompetent në mënyrën, e përcaktuar nga paragrafi 1 i këtij neni

17.3 Pas shpalljes së letërnjoftimit të humbur si të pavlefshëm, organi kompetent me kërkesë të shtetasit i lëshon atij letërnjoftimin e ri.

## **K R E U V**

### **EVIDENCAT**

### **Neni 18**

18.1 Evidencën mbi kërkesat e pranuar dhe letërnjoftimet e lëshuara i udhëheq dhe i mbanë Ministria.

18.2 Evidenca nga paragrafi 1 i këtij neni, përmban:

- a) të dhënat nga paragrafi 2 dhe 3 të nenit 16 të këtij ligji;
- b) datën e lëshimit të letërnjoftimit;
- c) afatin e vlefshmërisë së letërnjoftimit;
- d) numrin serik të regjistrimit të letërnjoftimit;
- e) të dhënat për letërnjoftimet e dëmtuara, të humbura, të vjedhura dhe të shpallura të pavlefshme;

f) të dhënat nga paragrafi 1 i nenit 12 të këtij ligji.

18.3 Të dhënat nga evidenca i udhëheqë Ministria, pesë vite pas pushimit të vlefshmërisë të letërnjoftimit.

18.4 Të dhënat për ndalimin e përdorimit të letërnjoftimit për kalimin e kufirit shtetëror organi kompetent i shkatërron pas pesë viteve, kur kalon arsyeja për këtë ndalesë.

## **Neni 19**

Institucionet shtetërore varësisht nga autorizimi i përcaktuar me ligj, mund t'i përdorin të dhënat nga evidenca për letërnjoftimet e lëshuara në pajtim me ligjin e aplikueshëm në Kosovë për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **K R E U VI**

### **MBIKËQYRJA**

## **Neni 20**

20.1 Mbikëqyrjen për zbatimin e dispozitave të këtij ligji e bënë Ministria e Punëve të Brendshme.

20.2 Ministria e Punëve të Brendshme, ka të drejtën të mbikëqyrë personin juridik, ndërmarrjet apo organizatat nga paragrafi 7 i nenit 8 të këtij ligji.

## **K R E U VII**

### **DISPOZITAT NDËSHKIMORE**

## **Neni 21**

Me gjobë prej njëqind (100) deri dyqind (200) € ose me burgim deri në tridhjetë (30) ditë dënohet për kundërvajtje shtetasi:

a) që nuk e ka letërnjoftimin valid, të pajisur me fotografi, që e ka lëshuar organi kompetent nga paragrafët 1 dhe 2 të nenit 4 të këtij ligji;

b) që me kërkesën e personit zyrtar, të autorizuar me ligj, nuk dëshiron ta jap për identifikim letërnjoftimin, sipas nenit 5 të këtij ligji;



- c) që letërnjoftimin e tij e jep apo huazon personit tjetër për përdorim ose përdor letërnjoftimin e huaj si të vetin, paragrafi 1 i nenit 6 të këtij ligji;
- d) që në kërkesën për tu pajisur me letërnjoftim, shënon të dhëna të pavërteta, paragrafi 4 i nenit 16 të këtij ligji;
- e) përdor letërnjoftimin në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 12 të këtij ligji;
- f) që ka më shumë se një letërnjoftim të vlefshëm, paragrafi 3 i nenit 4 të këtij ligji;
- g) që përdor letërnjoftimin e huaj me qëllim të sigurimit të ndonjë përfitimi apo të drejte, paragrafi 2 i nenit 6 të këtij ligji.

## **Neni 22**

Me gjobë prej pesëdhjetë (50) deri në dyqind (200) € do të dënohet për kundërvajtje shtetasi:

- a) që nuk ia dorëzon organit kompetent letërnjoftimin në afatin e caktuar në paragrafin 1 të nenit 13 të këtij ligji;
- b) që nuk e ka me vete letërnjoftimin;
- c) kur nuk ia dorëzon organit kompetent letërnjoftimin në afatin e caktuar pas paraqitjes së arsyeve për pushimin e vlefshmërisë së tij, paragrafi 2 i nenit 14 të këtij ligji;
- d) që në afatin e caktuar me ligj dhe në mënyrë të rregullt nuk e lajmëron organin kompetent për humbjen apo gjetjen e letërnjoftimit, paragrafi 1 dhe 2 i nenit 17 të këtij ligji.

## **Neni 23**

Të gjitha mjetet të cilat përfitohen nga gjobat, derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

# **KREU VIII**

## **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

## **Neni 24**

Ministria, tre muaj pas aprovimit të këtij ligji:

- a) cakton formën e formularëve nga nenet 8, 16, 17, dhe 18, të këtij ligji dhe mënyrën e evidentimit të ndalesës nga paragrafi 2 i nenit 12 të këtij ligji;
- b) cakton mënyrën e udhëheqjes së evidencës nga neni i 18 i këtij ligji;

c) cakton formën dhe mënyrën e punimit të letërnjoftimit si dhe, ruajtjen, përdorimin, kthimin dhe shkatërrimin e të dhënave nga neni 16 i këtij ligji.

#### **Neni 25**

Letërnjoftimi i lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund të përdoret deri në skadimin e vlefshmërisë së tij por jo më gjatë se një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **KREU IX**

#### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 26**

Ky ligj do të zëvendësojë të gjitha dispozitat e ligjit të aplikueshëm me të cilat është në papajtueshmëri.

#### **Neni 27**

Ministria e Punëve të Brendshme do të nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

### **KREU X**

#### **HYRJA NE FUQI**

#### **Neni 28**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-099**  
**3 tetor 2008**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**